Numër: 01/470
Datë: 13.10.2021

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe, Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve qe ofrojnë kualifikime ne Kosove, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 13.10.2021 nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. **Refuzohet** akreditimi i institucionit "Getting Competent", me adresë: Rr. Tring Smajli Nr.25/3, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, për kualifikimet:

   1.1. **INSTRUKTOR/MËSIMDHËNËS PËR TË RRITUR,** Niveli (V) sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 8 kredi të AAP.

   1.2. **TRAJNER NË KOMPANI,** Niveli (V) sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 5 kredi të AAP.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucioni "Getting Competent", me adresë: Rr. Tring Smajli Nr.25/3, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, për validim dhe akreditim të institucioni dhe rekomandimeve të dala nga Raportet e vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi validimin e kualifikimeve, si dhe Raportet e ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për validim të kualifikimeve/modulit; Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Ekipi i ekspertëve vlerësues nga data 09.07.2021 deri me 22.07.2021 kanë shqyrtuar dokumentacionin e institucionit "Getting Competent", ndërsa me datë 23.07.2021 ka vizituar institucionin "Getting Competent" lidhur me aplikimin për akreditim dhe validim për kualifikimet: 1. Instruktor/Mësimdhënës për të rritur, dhe 2. Trajner në Kompani.

Ekipi i ekspertëve vlerësues ka përgatitur raportet për validim dhe akreditim për institucionin "Getting Competent", për kualifikimet: 1. Instruktor/Mësimdhënës për të rritur, dhe 2. Trajner në Kompani. Duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me të njëjtin ekip të ekspertëve vlerësues dhe të njëjtin institucion, por kemi dy kualifikime, dhe duke u bazuar në raportet vlerësuese për validim të kualifikimeve dhe akreditim të institucionit e që nga raportet konstatohet se arsyetimi për refuzimin e akreditimit për kualifikimet e lartcekura i ekipit të ekspertëve vlerësues është i njëjtë, rrjedhimisht nga kjo edhe arsyetimi i këtij vendimi për të dyja kualifikimet do jete i përbashkët, duke theksuar dallimet vetëm në ato raste kur ekipi i eksperteve vlerësues ka dhënë vlerësime të ndryshme.

Ekipi i ekspertëve vlerësues në raportet e akreditimit për kualifikimet: 1. Instruktor/Mësimdhënës për të rritur, dhe 2. Trajner në Kompani, në pjesën 2 ku trajtohet **"Rezultatet e përgjithshme dhe përfundimet"**, ekspertët vlerësojnë se: "Referuar dokumentacionit të paraqitur nga ana e institucionit "Getting Competent", gjegjësisht kontratës për qira marrje, programi i trajnimit profesional "Instruktor/Mësimdhënës për te rritur" dhe "Trajner në kompani", janë planifikuar të realizohet në një hapësirë me sipërfaqe prej 19 m². Sipas klauzolës 1 të kontratës së qiramarrjes, për nevojat e institucionit "Getting Competent", nga ana e qiradhënësit "Inovation and Trainning Park" në Prizren, është dhënë në dispozicion ndërtesa e kuqe (ITP042), kati 2, zyrat me nr.232.
Gjate vizitës së realizuar me 23.07.2021 në këtë lokacion, panelit të eksperteve i është prezantuar një sallë tjetër mësimi në katin e fundit të ndërtesës (sipërfaqe përafërsisht 40m2, sipas deklarimeve të menaxhmentit). Institucioni nuk ka ofruar dëshmi se e ka zyrën e administratës dhe zyrën për sigurimin e cilësisë.
Gjate realizimit te vizitës, paneli i eksperteve vlerësues, nga deklarimet e menaxhmentit ka kuptuar se, institucioni "Getting Competent", nuk ka një sallë mësimi apo hapësirë të ndarë vetëm për nevojat e këtij institucioni, por varësisht nga kërkesa për trajnim, mund te marrin një hapësirë e cila mund te jete e lire për shfrytëzim, çka nënkupton se salla e prezantuar para grupit te eksperteve me kushtet infrastrukturore dhe mundësitë akomoduese të kandidateve te cilat i posedonte, mund te mos jetë ne dispozicion ne

momentin kur ka kërkesë për shfrytëzim nga ana e "Getting Competent". Aq me tepër, kjo salle mësimi nuk i përgjigjet hapësirës se përcaktuar sipas kushteve te kontratës.
Gjatë vizitës në këtë qendër u konstatua se: në një hapësirë të përbashkët (hapësirë e papërcaktuar- varësisht prej trajnimit dhe sallave të lira në objekt) mbahen si mësimi teorik dhe ai praktik për kualifikimin "Instruktor në vendin e punës" dhe në të njëjtën sallë trajnimi është planifikuar të organizohen edhe trajnime për dy profile tjera si: "Trajner në kompani" dhe "Instruktor/mësimdhënës për të rritur".
Nga dëshmitë e ndodhura në dosjen e aplikantit si dhe nga vlerësimet në ditën e vizitës, konstatohet se shoqata Getting Competent (Get-Com) nuk ka hapësirë të mjaftueshme (të përgjithshme) për ofrimin e kualifikimeve: "Instruktor/mësimdhënës për të rritur" dhe "Trajner në Kompani".
Në objektin e shoqatës gjatë vizitës nuk janë gjetur pajisje teknologjike dhe mjete didaktike si; kompjuter, video projektor, TV, por në sallën e trajnimit janë gjetur vetëm tavolina pune dhe karrige (kjo si pasoj e mos përcaktimit të saktë të sallave për trajnim dhe vlerësim e certifikim)!
Shoqata nuk ka ofruar marrëveshje të nënshkruar bashkëpunimi me organizata apo operatoret ekonomik shtetëror, biznese private, shkolla profesionale publike apo private apo me organizata vendore e ndërkombëtare. "

Këshilli Drejtues i AKK-së mbështetur në raportet e ekspertëve vlerësues lidhur me validimin dhe akreditimin e institucionit "Getting Competent" lidhur me aplikimin për akreditim dhe validim për kualifikimet: 1. Instruktor/Mësimdhënës për të rritur, dhe 2. Trajner në Kompani, niveli (V) sipas KKK, me tetë (8) respektivisht pesë (5) kredi të AAP, vendosi si në piken një (I) të dispozitivit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Institucionit "Getting Competent", dhe
2. Arkivit të AKK-së.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetar KD së AKK